

**Prishtina 16/12/2004**

**ERO Code: D\_01\_2004**

**Për: Z. Bashkim Ibrahim, Drejtor i Kompanisë së NQ Termokos**

**Për: Z. Remzi Hima, Drejtor i Kompanisë së NQ Gjakova**

**Për: Z. Osman Hajdini, Mbikqyrës i Ngrohjes Qëndrore, AKM**

**Copy: Mr. Ethem Çeku, Ministër i Energjisë dhe Minierave**

**Mr. Nikolaus Graf von Lambsdorf, ZPSSP, Shtylla e BE-së -UNMIK**

**Mr. Agron Dida, Zëvendës Ministër i Energjisë dhe Minierave**

**Mr. Peter Sorensen, Z/ZPSSP, Shtylla e BE-së - UNMIK**

**Mr. Andreas Wittkovsky, Kryesues i Zyrës Politike dhe Ligjore, Shtylla e BE-së - UNMIK**

**Mr. Josh Dick, Ushtrues i Detyrës së Drejtorit Menaxhues, AKM**

**Mr. Sean McGoldrick – Drejtor Ekzekutiv, KEK**

**Mr. Zoran Morvay – Këshillëtarë për Energji, Shtylla e BE-së.**

**Lënda:** Tarifa e Ngrohjes Qëndrore për sezonën 2004-2005

**Faqe:** 2 + 22

## **Zyra e Rregullatorit për Energji:**

Duke marrur parasyshë:

1. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/8 “Për Energjinë”
2. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/9 “Për Rregullatorin e Energjisë”
3. Rregulloren nr.2002/3 “Për Tatimin në Fitim në Kosovë”
4. Rregulloren nr.2001/30 “Për Themelimin e Bordit të Kosovës për Standardet e Raportimit Financiar dhe Regjimin për Raportim Financiar të Organizatave Biznesore”
5. Rregullorja nr.2001/11 “Për Tatimin e Vlerës së Shtuar në Kosovë”
6. Udhëzimin e Përkohëshëm nr 01/2004 “Mbi Principet e Kalkulimit të Çmimeve dhe Tarifave në Sektorin e Ngrohjes Qëndrore në Kosovë për Sezonën e Ngrohjes 2004/2005” të lëshuar nga ZRE-ja me 27 shtator, 2004
7. Letra e ZRE-së për Kompanitë e NQ-ve (Termokos, KNQ Gjakova dhe Termomit) “Udhëzimet e Përkohëshme për Sezonën e ngrohjes” të lëshuar me 14 Tetor 14, 2004
8. Kompanitë e NQ-së (Termokosi dhe KNQ Gjakova) letrat dhe dorëzimi i paketit të aplikacionit për tarifë për sezonën 2004/2005 me 12 nëntor, 2004.
9. Vendimi i anëtarëve të Bordit me 4 Dhjetor 2004

Vendos:

1. Ne aprovojmë vlerën tarifore për tërë përjdhën gjashtë mujore të Sezonës së Ngrohjes 2004 – 2005 ashtu siç prezantohet në tabelën e mëposhtme A dhe të kalkuluar detajisht nga metodologjia e presentuar në Dokumentin e Bashkangjitur Aneks I.
2. Vlera e aprovuar e tarifës, duhet të publikohet nga kompanitë përkthënë të ngrohjes, në një gazetë lokale dhe një kombëtare që qarkullojnë në Kosovë, brenda pesë (5) ditëve të punës pasi që Zyra e Rregullatorit për Energji të ketë shpallur dhe të ketë publikuar atë në Gazetën dhe Web-faqen e ZRE-së.
3. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRE) gjatë prjudhes së ardhëshme të ngrohjes do të përdorë të drejtat e dhëna me ligj, për të verifikuar të dhënat e prezentuara dhe llogaritë e kontrolluara dhe fakturat e Kompanive të Ngrohjes Qëndrore në të cilat është bazuar kalkulimi i tarifave.
4. Gjatë seznës së ngrohjes 2004/2005 Kompanitë e Ngrohjes Qëndrore mund të prezantojnë tek Zyra e Rregullatorit për Energji propozime për ndryshimet e arsyetueshme në tarifën e tyre të aprovuara, sipas udhëzimeve në Udhëzimin e Përkohëshëm të ZRE-së nr: 01/2004 “Për Parimet e Kalkulimit të Çmimeve dhe Tarifave në Sektorin e Ngrohjes Qëndrore në Kosovë për Sezonën Ngrohëse 2004/2005” të lëshuar me 27 shtator 2004.
5. Kompanitë e Ngrohjes Qëndrore kanë të drejtën për tu ankuar tek ZRE-ja duke dorëzuar një raport tërsisht të detajizuar, brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas shpalljes dhe publikimit të vendimit në Gazetën Zyrtëre dhe web-faqen e ZRE-së.

**TABELA A**  
**Shkallët e Tarifës për sezonën e ngrohjes 2004/05**

<b>Klasët e Konsumatorëve</b>	<b>Kompania e NQ-së “Termokos”</b>	<b>Kompania e NQ-së “Gjakova”</b>
<b>Amvisri</b>	<b>€0.85 / m<sup>2</sup> në muaj</b>	<b>€0.82 / m<sup>2</sup> në muaj</b>
<b>Komercial</b>	<b>€1.10 / m<sup>2</sup> në muaj</b>	<b>€1.25 / m<sup>2</sup> në muaj</b>

**Në emër të ZRE-së**

**Dr. Nick F Frydas**  
Kryesues i Komisionit